

PROCESVERBAL

(administrativ)

I mbajtur sot në datë 11.12.2012, ndërmjet anëtarëve të grupit të mbikqyrjes së KSHC-së Behare Hoxha, Edvjol Gogo dhe z.Gjergj Teneqexhiu, Sekretar i Përgjithshëm dhe znj.Merita Sanxhaku drejtore e Drejtorisë së Personelit dhe Financës në Institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e vendimit nr.19, datë 14.05.2012 të Komisionit të Shërbimit Civil.

Nga verifikimet e kryera konstatohet se:

1. Lidhur me hartimin e strukturës dhe organikës së re:

Me urdhërin nr.57, datë 06.06.2012 të Avokatit të Popullit është ngritur grupi i punës për rishikimin e strukturës dhe organigramës së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Me urdhërin nr.98, dt.24.09.2012 të Avokatit të Popullit është miratuar struktura dhe organika e Institucionit të Avokatit të Popullit. Në hartimin e strukturës dhe organikës së re janë mbajtur parasysh rekomandimet e bëra në Raportin Përfundimtar të Mbikqyrjes së realizuar dhe të finalizuar me vendimin nr.19., datë 14.05.2012 të KSHC.

2. Lidhur me rishikimin e rregullores së institucionit:

Me urdhërin nr.124, datë 31.10.2012 të Avokatit të Popullit është ngritur grupi i punës për rishikimin e rregullores së brendshme të institucionit. Grupi i punës drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Është parashikuar që projekt rregullorja e re të hartohet në përputhje me Rezolutën e Kuvendit, rekomandimet e Euralius dhe të KSHC si dhe me detyrimet që burojnë nga marrja e statusit të vendit kandidat për në BE. Hartimi i projekt rregullores së re është në proces.

3. Lidhur me plotësimin e strukturës së institucionit:

Konstatohet se fillimisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për **5 vendet e punës të gjetura me emërim të përkohshëm.**

- Me urdhërin nr.60/1, datë 05.07.2012 të titullarit të institucionit janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për **z.V.Imeraj.**
- Me urdhërin nr.61/2, datë 05.07.2012 të titullarit të institucionit janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për **znj.A.Shyti.**
- Me urdhërin nr.62/1, datë 05.07.2012 të titullarit të institucionit janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për **z.A.Kocobashi.**
- Me urdhërin nr.68/1, datë 05.06.2012 janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për **z.A.Kruja.**
- Me urdhërin nr.35/1, dt.02.05.2012 të titullarit të institucionit janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për **z.A.Leka.**

Procesi i ndërprerjes së emërimeve me kontratë si dhe procesi i hartimit dhe miratimit të strukturës dhe organikës së re të institucionit është shoqëruar me krijimin e 13 vendeve të lira pune.

Me krijimin e vendeve të lira kanë nisur menjëherë procedurat e pranimit në shërbimin civil.

Në momentin e kryerjes së këtij verifikimi rezulton se:

- **Për 4 vende pune kanë përfunduar procedurat e rekrutimit**, konkretisht 1 emërim është kryer me procedurën e lëvizjes paralele (akti nr.41, dt.15.05.2012 për emërimin e z.Gj.Teneqexhiu në pozicionin Sekretar i Përgjithshëm), 2 emërimet për pozicionin Nd/Komisioner janë kryer me procedurën e konkurimit të hapur (akti nr.83/3, dt.01.10.2012 për emërimin e z.A.Kruja në pozicionin Nd/Komisioner në Njësinë e Parandalimit të Torturës dhe akti nr.83/4, dt.01.10.2012 për emërimin e z.A.Koçobashi në detyrën Nd/Komisioner në Njësinë e Parandalimit të Torturës), për 1 vend pune (për pozicionin specialist i administratës) është shpallur rezultati përfundimtar i konkurimit.
- **Për 9 vende pune procedurat e konkurimit janë në proces** (janë në proces procedurat e rekrutimit për 2 vende të lira për pozicionin Nd/Komisioner, 1 vend pune për pozicionin drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve ndaj Qytetarëve, 1 vend pune për pozicionin Përgjegjës i Pritjes së Popullit - Marrëdhëniet me Jashtë, 2 vende të lira për pozicionin Specialist Shërbimi ndaj Qytetarit, 2 vende të lira për pozicionin Specialist i Koordinimit të Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimin).

4. Hartimi i përshkrimeve të punës

Ky proces ka filluar dhe do të përmbyllet në momentin e miratimit të rregullores së re të institucionit.

5. Plotësimi i formularëve të vlerësimit të arritjeve vjetore në punë

Mbështetur në Udhëzimin e KM nr.2, datë 07.07.2000 "Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore, individuale të nëpunësve civilë" të ndryshuar me udhëzimin e KM nr.5, dt.19.12.2007, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit me shkresën nr.123 prot., datë 26.10.2012 drejtuar e eprorëve të drejtpërdrejtë të linjës (Komisionerëve dhe drejtorëve të drejtorive) që të bëjnë vlerësimin e mbarëvajtjes vjetore në punë për punonjësit e tyre.

Konstatohet se vlerësimet janë kryer nga eprorët e drejtpërdrejtë dhe i janë dorëzuar strukturës eprorë Sekretarit të Përgjithshëm për të vijuar përmbylljen e procedurës.

Falenderojmë personat e kontaktit të Institucionit të Avokatit të Popullit që bashkëpunuan me inspektorët e KSHC.

Ky procesverbal nënshkruhet:

Inspektorët e KSHC

Behare Hoxha

Edvjol Gogo

**Personat e kontaktit të
Avokatit të Popullit**

**Sekretari i Përgjithshëm
Gjergj Teneqexhiu**

**Dr. e Dr. së Personelit & Administratës
Merita Sanxhaku**